

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7137  
E shtunë, 9 mars 2024  
Çmimi 0.50 €

Shqiptari  
nominohet  
për  
ambasador  
të ShBA-së në  
Mal të Zi:  
U jam  
falënderues  
Bidenit dhe  
Blinkenit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

MË 21 PRILL TË KËTIJ VITI VOTOHET PËR LARGIMIN E KATËR KRYETARËVE  
SHQIPTARË NË VERI TË KOSOVËS | FAQE 4-5

## KQZ-JA HAP RRUGËN PËR LARGIMIN E KRYETARËVE NË VERI



Me tetë vota për dhe dy abstenime të PDK-së, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë votuar rekomandimin që më 21 prill të votohet për apo kundër largimit të katër kryetarëve

shqiptarë në komunat në veri të Kosovës. Ky rekomandim ka ardhur nga sekretariati i KQZ-së, pasi ka verifikuar nënshkrimet e dorëzuara të peticionit nga kuvendet komunale të Leposaviqit, Zveçanit,

Zubin Potokut dhe Mitrovicës së Veriut. Këtë rekomandim të KQZ-së e ka përshëndetur shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, i cili ka kërkuar që të krijohen kushtet për votim të lirë dhe të drejtë

## THIRRJE PËR BARAZI DHE DREJTËSI PËR GRATË NË KOSOVË | F. 7



PUSHTETI THOTË SE KA RËNIE TË KORRUPSIONIT  
VITET E FUNDIT, OPOZITA PËRMEND  
NDËRHYRJET DHE LIGJET ANTIKUSHTETUESE | F. 5

## AKTUALE



PROKURORIA SPECIALE, EDHE 26  
VJET PAS, ENDE PA AKTAZUË PËR  
MASAKRËN E PREKAZIT | F. 3

DIGJETI LOKALI I NËNKRYETARES  
SË ZVEÇANIT | F. 5

ISH-MINISTRI MEHAJ EMËROHET  
KËSHILLTAR I JASHTËM  
I KRYEMINISTRIT KURTI | F. 7

PDK-JA: NUK DO TË LEJOJMË QË TË  
KALOJË LIGJI PËR ZYRTARËT  
PUBLIKË | F. 7

## EKONOMI



REGJISTRIMI I POPULLSISË, 10 MIJË  
EURO SHPËRBLIM KUSH E QËLLON  
NUMRIN E SAKTË | F. 8

DEPUTETI LUSHTAKU KËRKON  
LEJIMIN E IMPORTIT TË VETURAVE  
MË TË VJETRA SE 10 VJET, ODA  
AMERIKANE KUNDËR | F. 8

## SPORT



DY DERBI NË SUPERLIGË | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Bideni: Nuk do të përkulemi para Putinit

UASHINGTON, 8 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka kritikuar kundërshtarin e tij të mundshëm republikan, Donald Trump, për "përkulje" ndaj presidentit rus, Vladimir Putin, dhe i ka kërkuar Kongresit Amerikan ta miratojë ndihmën për Ukrainën, duke paralajmëruar se demokracia në të gjithë botën është nën kërcënim.

Bideni ka mbajtur të enjten mbërma fjalimin vjetor drejtuar kombit, në një seancë të përbashkët të Kongresit. Ai e ka kritikuar Trumpin për komentet e fundit në lidhje me NATO-n - aleancën e mbrojtjes të udhëhequr nga ShBA-ja, e cila shënon 75-vjetorin e themelimit këtë vit.

Duke folur gjatë një tubimi muajin e kaluar, Trumpi ka thënë se derisa shërbente si president, e ka paralajmëruar një aleat të NATO-s se "do ta inkurajonte Rusinë të bëjë çfarë dreqi do" me ata anëtarë të aleancës që nuk paguajnë sa duhet për qëllime të mbrojtjes. Deklarata ka shkaktuar frikë se Trumpi mund të përpiqet ta

tërheqë ShBA-në nga NATO-ja, nëse i fiton zgjedhjet presidenciale në nëntor. "Të përkulesh para një udhëheqësi rus është skandaloz, e rrezikshme dhe e papranueshme", ka thënë Bideni, duke iu referuar Trumpit, ndërsa kujtoi sesi ish-presidenti Ronald Reagan - i cili mbahet mend me dashuri nga republikanët - i është kundërvënë Kremlinit gjatë Luftës së Ftohtë.

Bideni ka thënë se NATO-ja është "më e fortë se kurrë" dhe veçoi kryeministrin suedez, Ulf Kristersson, në audiencë.

Në ditën që ai mbajti fjalimin, Suedia është bërë zyrtarisht anëtarja e 32-të e NATO-s, duke u dhënë fund 200 vjetëve të neutralitetit ushtarak.

Suedia ka aplikuar për t'iu bashkuar aleancës së mbrojtjes pasi Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në vitin 2022.

Bideni i ka bërë thirrje Kongresit që ta miratojë një projektligj për ndihmë për Ukrainën, duke paralajmëruar se Putini nuk do të ndalet në kufirin me Ukrainën.



Një grup i republikanëve të krahut të djathtë në Dhomën e Përfaqësuesve ka muaj që bllokoi projektligjin, që do t'i ndante rreth 60 miliardë dollarë ndihmë ushtarake, ekonomike dhe humanitare Ukrainës, e cila lufton kundër pushtuesve rusë. Bllokada në Uashington ka bërë që forcat ukrainase të mbeten pa municione e armë - gjë që i mundësoi Rusisë të shënojë disa fitore në fushëbetje. Muajin e kaluar ajo ka pushtuar qytetin lindor Avdijivka, duke arritur kështu fitoren e parë në më shumë se një vit. "Ukraina mund ta ndalojë Putinin nëse ne qëndrojmë me Ukrainën dhe

ia sigurojmë armët që i nevojiten për t'u mbrojtur. Ne duhet të ngrihemi kundër Putinit", ka thënë Bideni.

Nëse Shtetet e Bashkuara tërhiqen, ka thënë ai, "Ukraina do të jetë në rrezik, Evropa do të jetë në rrezik, bota e lirë do të jetë në rrezik".

"Mesazhi im për presidentin Putin është i thjeshtë. Ne nuk do të tërhiqemi. Ne nuk do të përkulemi. Unë nuk do të përkulem", ka thënë ai.

Bideni e ka kritikuar Trumpin edhe për përpjekjet e tij për t'i përmbysur rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2020, duke thënë se ato kanë përbërë

kërcënim të madh për demokracinë në vend. "Nuk mund ta duash vendin tënd vetëm kur fiton", ka thënë ai, duke iu referuar jo vetëm Trumpit, por edhe republikanëve në Kongres, të cilët i mbështesin pretendimet e ish-presidentit se zgjedhjet e vitit 2020 kanë qenë të manipuluar.

Fjalimi i Bidenit këtë vit ka një rëndësi më të madhe, pasi ai do të hyjë në garën për rizgjedhje në nëntor - sipas të gjitha gjasave - kundër Trumpit. Fjalimi mund të jetë mundësia më e madhe që ka për të arritur te votuesit amerikanë përpara zgjedhjeve.

Bideni e ka mundur Trumpin në vitin 2020, por përballet me një garë të vështirë për rizgjedhje për shkak të vlerësimeve të ulëta. Një sondazh i Qendrës së Kërkimeve, Pew, i publikuar në janar, gjeti se vetëm 33 për qind e amerikanëve e miratojnë performancën e Bidenit në punë, ndërsa 65 për qind nuk e miratojnë. Vlerësimi i punës së Bidenit ishte nën 40 për qind gjatë dy vjetëve të fundit.

## UNICEF-i: Më shumë se 230 milionë gra dhe vajza i janë nënshtruar gjymtimit gjenital

NJU-JORK, 8 MARS - Më shumë se 230 milionë gra dhe vajza i janë nënshtruar gjymtimit gjenital femëror, shumica prej të cilave jetojnë në Afrikë, u tha në një raport të publikuar më 8 mars nga Agjencia për Fëmijë e Kombeve të Bashkuara (UNICEF).

Në të paktën tetë vjetët e fundit, afër 30 milionë persona i janë nënshtruar kësaj procedure, përmes së cilës organet gjenitale të jashtme hiqen pjesërisht apo plotësisht, u tha në raportin e UNICEF-it që u publikua në Ditën Ndërkombëtare të Gruas.



Përqindja e grave dhe vajzave që përjetojnë gjymtim gjenital është në rënie, tha UNICEF. Por, kjo agjenci paralajmëroi se përpjekjet për ta zhdukur këtë praktikë janë shumë të ngadalshme duke pasur

parasysh rritjen me shpejtësi të popullsisë. "Praktika e gjymtimit gjenital femëror po bie, por jo me shpejtësinë e duhur", është thënë në raport.

Praktika, që gabimisht besohet se

kontrollon seksualitetin e grave, mund të shkaktojë gjakderdhje të madhe, madje edhe vdekje. Subjekt i kësaj procedure janë vajzat nga mosha të ndryshme, duke nisur nga koha kur ato janë foshnja e deri në adoleshencë. Në aspektin afatgjatë, një praktikë e tillë mund të çojë tek infeksionet e traktit urinar, probleme me ciklin menstrual, ulje të kënaqësisë seksuale dhe ndërlikime gjatë lindjeve, por mund të shkaktojë edhe depresion, vetëbesim të ulët dhe sëmundjen e stresit post-traumatik.

Sipas raportit të UNICEF-it, afër 144 milionë gra dhe vajza i janë nënshtruar gjymtimit gjenital vetëm në Afrikë, pasuar nga Azia dhe Lindja e Mesme me 80 milionë, respektivisht 6 milionë. Somalia është në krye të listës së shteteve ku kjo praktikë është mbizotëruese me 99 për qind të popullatës femërore nga mosha 15 deri në 49 vjeç që i janë nënshtruar kësaj procedure.

Ndërsa Burkina Faso ka shënuar përparimin më të madh, pasi në tri dekadat e fundit kjo praktikë është ulur nga 80 për qind në 30 për qind.

## Ambasada e ShBA-së paralajmëron për një sulm ekstremist në Moskë

MOSKË, 8 MARS - Ambasada Amerikane në Rusi ka paralajmëruar qytetarët amerikanë që t'i shmangin tubimet e mëdha në Moskë për shkak të asaj që tha se ish-informatorit raportime se ekstremistët kanë plane të afërta për të kryer një sulm. Ambasada Amerikane, që vazhdimisht u ka bërë thirrje shtetasve amerikanë të largohen menjëherë nga Rusia, nuk dha detaje të tjera lidhur me natyrën e kërcënimit, por tha se njerëzit

duhet t'i shmangin turmat. "Ambasada po monitoron raportimet se ekstremistët kanë plane të afërta për të shënjestruar tubime të mëdha në Moskë, përfshirë koncertet dhe shtetasit amerikanë këshillohen t'i shmangin tubimet e mëdha gjatë 48 orëve të ardhshme", është thënë në mesazhin e Ambasadës të publikuar në uebfaqen e saj.

Lufta që Rusia nisi në Ukrainë më 2022 ka nxitur krizën më të thellë në raportet mes Moskës

dhe Perëndimit që nga Kriza kubane e raketave më 1962 dhe presidenti rus, Vladimir Putin, ka paralajmëruar se Perëndimi rrezikon ta provokojë një luftë bërthamore nëse dërgon trupa për të luftuar në Ukrainë.

Kremlini ka thënë se raportet me Shtetet e Bashkuara kurrë nuk kanë qenë më të këqija dhe ka thënë se ShBA-ja po lufton kundër Rusisë duke mbështetur Ukrainën me para, armë dhe inteligjencë.





# Pushteti thotë se ka rënie të korrupsionit vitet e fundit, opozita përmend ndërhyrjet dhe ligjet antikushetuese

Çështja e korrupsionit, nepotizmi dhe ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë, kanë ballafaquar të premtën pushtetin me opozitën. Përfaqësuesit e pushtetit kanë thënë se vitet e fundit është duke u luftuar korrupsioni, ndërsa ata të opozitës e kanë akuzuar mazhorancën se është duke ndërhyrë në çdo institucion publik. Po ashtu, ata ia kanë përmendur pushtetit edhe miratimin e ligjeve antikushetuese

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MARS - "Ndikimi i korrupsionit politik në kulturën qeverisëse" ishte tema e diskutimit ndërmjet mazhorancës dhe opozitës. Në konferencën e organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ku është lansuar Studimi i Sistemit të Integritetit Kombëtar (NIS), ka pasur akuza dhe kundërkuzat në lidhje me korrupsionin në Kosovë. Partitë opozitare e kanë akuzuar pushtetin për ndërhyrje në institucione dhe nivelin e lartë të korrupsionit, ndërsa mazhoranca ka theksuar se është duke luftuar korrupsionin.

Shefja e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza-Kusari-Lila, ka thënë se raporti përmban një vlerësim objektiv mbi realitetin dhe sfidat që kanë institucionet në luftimin e korrupsionit. Ajo ka theksuar se në këtë raport Kosova ka rënie të korrupsionit vitet e fundit për shkak të angazhimeve institucionale. Si shembull, Kusari-Lila ka kërkuar që të merret gjendja në PTK.

"Një prej storieve të suksesit

është Posta e Kosovës, e cila, nga një ndërmarrje me keqmenaxhim të theksuar, ka arritur në ndërmarrje me ndërhyrje të rritura në secilën degë, dhe që gjatë tri viteve të fundit ka pasur bord të shkëlqyer, duke filluar edhe nga kuota gjinore dhe profesionalizimi", ka thënë ajo. Ndërsa deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti karakterizohet me vendime antikushetuese. "Ka pasur tendencë të hapur për kapje të institucioneve dhe, për pasojë, duket se do të kemi një projektligj që synon kapjen e institucionit ligjor (Këshillit Prokurorial të Kosovës). Ligji i Pagave, zvogëlimi i tyre në sektorin e drejtësisë, në përpjekje për kërcënimin e institucioneve të pavarura, një përpjekje për ndryshim që s'e kemi parë deri më tani", ka thënë Deliu-Kodra.

Ajo ka përmendur edhe ndërhyrjet të Ligji i KPM-së dhe gjuhën kërcënuese ndaj gazetarëve. "Prapë po e them se çfarë kemi parë është vërtet e dhimbshme dhe nuk e karakterizon integritetin e duhur



institucional", ka thënë ajo. Ndërsa shefi i deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arben Gashi, ka thënë se kultura e qeverisjes së Kurtit është kulturë e presionit publik, duke thënë se nuk merr përgjegjësi edhe nëse i rrezikon themelet e shtetit. "Mund të themi se është qeveria që ka sjellë më së shumti ligje antikushetuese. Ka zgjidhje, por duhet të vendoset së pari gjendje e jashtëzakonshme. Nuk mund t'i pakësojë liritë ekonomike, pastaj edhe kryeprokurorit të shtetit, me ndërhyrje direkte. Kjo tregon tendencë direkte për

ndërhyrje në institucione. Imponimi i vendimeve të deputetëve është problem i kësaj qeverisje e cila është e rrezikshme për stabilitet institucional", ka thënë Gashi. Ai ka thënë se qeveria aktuale është qeveria që më së shumti ka dhënë tenderë njëburimor, duke shtuar se kjo kalon numrin e mbi 350 sosh. Më tutje, shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti është shquar për nepotizëm. "Me nepotizmin e bërë nga kjo qeveri nuk ka dëm 4-vjeçar, por

më shumë se 15-vjeçar", ka thënë ai.

Tahiri ka përmendur edhe ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë, duke thënë ato janë duke vazhduar ende.

Për këto akuza Tahirit i ka replikuar Kusari-Lila e Vetëvendosjes. "Vazhdimisht po e akuzojnë qeverinë për ndërhyrje në organe të rendit, dhe ajo që po ndodh në sistemin legjislativ është se janë miratuar një mori projektligjesh, si ai i vettingut, financimi për partitë politike, ndryshime të mandatit të Agjencisë Anti-korrupsion...", ka thënë Kusari-Lila.

## Prokuroria Speciale, edhe 26 vjet pas, ende pa aktakuzë për masakrën e Prekazit



©SEFER ALIQAJA

PRISHTINË, 8 MARS - Forca të shumta paramilitare serbe e kishin rrethuar familjen Jashari në Prekaz të Skenderajt në mars të vitit 1998. Më 5, 6 dhe 7 mars të atij viti, pas një rezistence të hekurt, është vrarë komandanti Adem Jashari, me 58 familjarë e të afërm të tij, përfshirë fëmijë, gra dhe pleq.

Janë mbushur 26 vjet që nga ky sulm, por për ngjarjen që ka ndryshuar rrjedhën e historisë së Kosovës, ende nuk ka aktakuzë, ndonëse Prokuroria Speciale ishte thënë se kishte filluar hetimet qysh në vitin 2019, raporton "Betimi për Drejtësi".

Ishte ish-prokurorja speciale Drita Hajdari e cila kishte deklaruar se në 2019 kishin filluar hetimet dhe se ishin në fazën e grumbullimit të provave. "Kam verifikuar nëse rasti është hapur nga EULEX-i apo UNMIK-u apo nga Tribunali i Hagës dhe pasi që kam kuptuar se nuk ka rast të

hapur, kam vendosur për hapjen e hetimit me qëllim të zbardhjes së këtij rasti dhe të përgjegjësisë penale për krimet e luftës në rastin konkret", kishte deklaruar ajo në medie.

E kontaktuar të premtën, Hajdari ka thënë se meqenëse më nuk është prokurore, s'ka kompetencë të përgjigjet lidhur me këtë temë. Por, në një përgjigje për "Betimi për Drejtësi", kryeprokurori i PSRK-së, Blerim Isufaj, ka thënë se s'ka shumë kohë që janë hapur hetimet zyrtarisht. "Kanë filluar (hetimet). Nuk është kohë e gjatë kur zyrtarisht, por po kanë filluar. Veç mund të konfirmoj që i kemi hetimet e aktivizuara me vendim, por asgjë më shumë", ka thënë Isufaj.

Se kur kanë filluar këto hetime dhe nëse ka pasur pezullime në ndonjë periudhë, nuk është përgjigjur as prokurori i rastit, Valdet Gashi.





MË 21 PRILL TË KËTJË VITI VOTOHET PËR LARGIMIN E KATËR KRYETARËVE SHQIPTARË NË VERI TË KOSOVËS

# KQZ-ja hap rrugën për largimin e kryetarëve në veri

Me tetë vota për dhe dy abstenime të PDK-së, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë votuar rekomandimin që më 21 prill të votohet për apo kundër largimit të katër kryetarëve shqiptarë në komunat në veri të Kosovës. Ky rekomandim ka ardhur nga sekretariati i KQZ-së, pasi ka verifikuar nënshkrimet e dorëzuara të peticionit nga kuvendet komunale të Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës së Veriut. Këtë rekomandim të KQZ-së e ka përshëndetur shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, i cili ka kërkuar që të krijohen kushtet për votim të lirë dhe të drejtë

**EPOKA E RE**

**Lirim GEÇI**

**PRISHTINË, 8 MARS** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar të premten rekomandimin e sekretariatit të këtij institucioni që votimi për shkarkimin e katër kryetarëve në veri të mbahet më 21 prill të këtij viti.

Rekomandimi është miratuar më 8 vota për dhe dy abstenime. Në këtë mbledhje kanë abstenuar dy përfaqësuesit e PDK-së. "Më 8 vota për, dy abstenime, miratohet data për mbajtjen e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve më datë 21 prill 2024", ka thënë kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi. Këtë datë për mbajtjen e votimit e ka propozuar kryeshefi i sekretariatit të KQZ-së, Burim Ahmetaj. Para anëtarëve të KQZ-së ai ka treguar për verifikimin e nënshkrimeve të mbledhura nga katër grupet nismëtare në peticionin e organizuar në komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe të dorëzuara në KQZ nga kryesuesit e kuvendeve komunale të këtyre komunave.

Në adresimin e tij, ai ka treguar se peticioni në katër komunat përmbush kushtet ligjore. "Nga

peticioni i organizuar në komunën e Leposaviqit, KQZ-ja ka pranuar për verifikim listën me 3 030 nënshkrime të plotësuara në 304 faqe, nga të cilat, pas krahasimit me të dhënat e listës votuese të bazuar në numrin personal, rezulton se 2 905 nënshkrues të peticionit janë qytetarë të Kosovës me të drejtë vote në këtë komunë. Numri i përgjithshëm i votuesve në këtë komunë është 13 441 votues, ndërsa 2 689 votues përbëjnë 20 përqind të listës votuese. Këto nënshkrime të mbledhura përbëjnë 20 përqind të votuesve në këtë komunë", ka thënë ai, duke treguar se edhe peticioni në Zubin Potok është në rregull. "Nga peticioni i organizuar në komunën e Zubin Potokut, KQZ ka pranuar për verifikim listën me 1 576 nënshkrime të plotësuara në 158 faqe, nga të cilat, pas krahasimit me të dhënat e listës votuese të bazuar në numrin personal, rezulton se 1 380 nënshkrues të peticionit janë qytetarë të Kosovës me të drejtë vote në këtë komunë. Numri i përgjithshëm i votuesve në këtë komunë është 6 732 votues, ndërsa 1 347 votues përbëjnë 20 përqind të listës votuese. Këto nënshkrime të mbledhura përbëjnë 20 përqind të votuesve në këtë komunë", është shprehur Ahmetaj.

Sipas tij, as në peticionin e organizuar në Zveçan nuk është bërë ndonjë shkelje. "Nga peticioni i organizuar në komunën e Zveçanit, KQZ ka pranuar për verifikim listën me 1 834 nënshkrime të plotësuara në 185 faqe, nga të cilat, pas krahasimit me të dhënat e listës votuese të bazuar në numrin personal, rezulton se 1 714 nënshkrues të peticionit janë qytetarë të Kosovës me të drejtë vote në këtë komunë. Numri i përgjithshëm i votuesve në këtë komunë është 7 052 votues, ndërsa 1 411 votues përbëjnë 20 përqind të listës votuese. Këto nënshkrime të mbledhura përbëjnë 20 përqind të votuesve në këtë komunë", ka thënë ai, duke shtuar se edhe me peticionin në Mitrovicë të Veriut ka qenë gjithçka në rregull. "Nga peticioni i organizuar në komunën e Mitrovicës së Veriut, KQZ ka pranuar për verifikim listën me 4 148 nënshkrime të plotësuara në 423 faqe, nga të cilat, pas krahasimit me të dhënat e listës votuese të bazuar në numrin personal, rezulton se 3 653 nënshkrues të peticionit janë

qytetarë të Kosovës me të drejtë vote në këtë komunë. Numri i përgjithshëm i votuesve në këtë komunë është 18 199 votues, ndërsa 3 640 votues përbëjnë 20 përqind të listës votuese. Këto nënshkrime të mbledhura përbëjnë 20 përqind të votuesve në këtë komunë", është shprehur Ahmetaj. Sipas udhëzimit administrativ që mundëson largimin e kryetarëve të komunave, të miratuar shtatorin e vitit të kaluar, që ky votim të jetë i suksesshëm, duhet 50 përqind, plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote. Pas kësaj, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat ligjor prej 30 deri në 45 ditë për ta shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Mbledhja e nënshkrimeve në katër komunat në veri, të banuara me shumicë serbe, u bë në janarin e këtij viti. Kryetarët shqiptarë janë zgjedhur në prill të vitit 2023 në zgjedhjet të cilat ishin bojkotuar nga serbët në shenjë pakënaqësie me politikat e Qeverisë së Kosovës.

Nisja e detyrës së tyre kishte nxitur tensione në fund të majit të vitit të kaluar të cilat kulmuan në Zveçan, pasi protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Bashkësia ndërkombëtare kishte kërkuar uljen e tensioneve dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri të Kosovës. Peticioni është nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Listës Serbe, parti e cila ka bojkotuar zgjedhjet e prillit të vitit 2023. Kjo parti, që është partia më e madhe në Kosovë e serbëve dhe që ka mbështetjen e Beogradit, kishte iniciuar largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe më pas kishte bërë thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të prillit të vitit të kaluar. Largimi nga institucionet është bërë në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me ndërrimin e targave të makinave nga ato të lëshuara nga Serbia në ato që lëshohen nga Kosova, por që atëherë kjo çështje është zgjidhur. Mirëpo, në mesin e tetorit të vitit 2023, kjo parti kishte deklaruar se ishte e gatshme të merrte pjesë në zgjedhjet në komunat në veri, pa vendosur asnjë kusht për pjesëmarrje në zgjedhje, siç kishte bërë më herët. Ky qëndrim i kësaj partie është marrë pasi presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, u kishte bërë thirrje përfaqësuesve serbë në veri të Kosovës që ta inicionin mbajtjen e zgjedhjeve të reja në mënyrë që "levat kryesore të pushtetit të jenë në duart e tyre". Kësaj thirrjeje i ka paraprirë një sulm i armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, kur një grup serbësh sulmuan Policinë e Kosovës duke vrarë një polic. Përgjegjësinë për sulmin e mori ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq.

## Szunyogu përshëndet vendimin e KQZ-së: Tani të krijohen kushte për votim të lirë e të drejtë

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka përshëndetur vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ta caktuar datën për votimin për shkarkimin të kryetarëve në katër komunat veriore. "Vlerësojmë procesin e verifikimit të nënshkrimeve nga KQZ-ja dhe vendimin e tyre për ta caktuar datën për votim për shkarkimin e kryetarëve të komunave", ka

shkruar Szunyog në platformën "X". Szunyogu është shprehur se i mbetet KQZ-së të përgatitet të krijojë kushte për votim të lirë e të drejtë. "Tani është thelbësore që KQZ-ja t'i bëjë përgatitjet e nevojshme për të siguruar proces të qetë dhe të krijojë kushte për votim të lirë dhe të drejtë. BE-ja është e gatshme të ofrojë mbështetje përgjatë këtij procesi", ka shtuar Szunyog.



## Digjet lokali i nënkryetares së Zveçanit

**ZVEÇAN, 8 MARS** - Nënkyetaria e komunës së Zveçanit, Natasha Tomaniq, ka njoftuar se një lokal në pronësi të saj është djegur në orët e para të 8 marsit.

Veton Elshani, zëvendës drejtor i policisë për rajonin e veriut, ka thënë se zjarri "dyshohet se është shkaktuar qëllimisht". "Veprimet hetimore janë duke

u zhvilluar", ka thënë Elshani. Tomaniq, që është nënkryetare e komunës së Zveçanit që funksionon sipas sistemit të Kosovës, ka thënë se zjarrvënja nuk ishte "e rastësishme", duke shtuar se dyshon se motivi është se ajo ka ndihmuar serbët në veri të Kosovës të punësohen në institucionet e Kosovës.

Ajo ka theksuar se aktivitetet e saj "nuk përshtaten" me Listën Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit. "Atëherë kam një pyetje për ta. Pse po luftojnë që të kthehen në institucionet e Kosovës, nëse ne që kemi hyrë në institucionet e Kosovës jemi tradhtarë?", ka thënë ajo.

Tomaniq ka thënë se dëmi i shkaktuar nga zjarri kap vlerën e disa mijëra eurove. Kjo nuk është hera e parë që pronave personale të pjesëtarëve të komunitetit serb në komunat në veri të banuara me shumicë serbe u vuhet flaka. Në vitin 2023 ishin djegur dhjetëra



vetura, pasi pronarët e tyre i kishin konvertuar targat nga ato serbe në RKS – Republika e Kosovës.

# Si po u shmanget Serbia masave ndëshkuese të BE-së për Banjskën?

**BRUKSEL, 8 MARS** - Bashkimi Evropian (BE) nuk ka gatishmëri për t'i vënë masa ndëshkuese Serbisë pas sulmit të armatosur që ndodhi në fshatin Banjskë në veri të Kosovës, dhe standardet e dyfishta të bllokut evropian nuk përbëjnë asgjë të re, kështu i kanë thënë Radios Evropa e Lirë burime diplomatike në Bruksel dhe ekspertë të huaj. Sipas tyre, thirrjet në aspekte procedurale, dhe në mungesën e një raportit përfundimtar nga autoritetet e Kosovës, janë vetëm arsye të zvarritjes së rastit.

"Perëndimi nuk ka apetit për të marrë ndonjë masë kundër (presidentit të Serbisë, Aleksandër) Vuçiq, dhe ndaj kujtdo që ka qenë i përfshirë... Perëndimi ka nevojë për Serbinë dhe nuk dëshiron ta dëmtojë këtë marrëdhënie delikate", ka vlerësuar analisti Toby Vogel, bashkëpunëtor i Këshillit për Politikën e Demokratizimit, në disa përgjigje për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova, në anën tjetër, ngulmon për vendosjen e masave ndaj Serbisë, pasi deklaroi se ndaj saj është kryer sulm terrorist.

### Çfarë ndodhi në Banjskë?

Më 24 shtator 2023, një grup i armatosur serbësh vrau rreshterin e Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, në Banjskë të komunës së Zveçanit. Si pasojë e përlshjeve të mëtejme u vranë edhe tre sulmues serbë. Kosova e mban përgjegjësinë shtetin e Serbisë për këtë sulm, ndërsa Beogradi zyrtar e kundërshton këtë



qëndrim.

Ish-nënkyetari i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - Millan Radoiqiç, më vonë e mori përgjegjësinë për sulmin.

Autoritetet e Serbisë kanë nisur një proces gjyqësor kundër tij, por e kanë liruar nga masa e paraburgimit, me kushtin që të mos shkojë më në Kosovë.

Organizata Ndërkombëtare e Policisë, e njohur më shumë si INTERPOL, ka lëshuar fletarrestim kundër tij.

Perëndimi e ka dënuar ashpër sulmin në Banjskë, por masat ndëshkuese të kërkuara aq shumë prej autoriteteve të Kosovës nuk janë vënë në kurrë.

### Në pritje të raportit të Kosovës...

Bashkimi Evropian e ka pranuar vitin e kaluar një raport prej 48-faqesh nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës për sulmin në Banjskë. Megjithatë, burimet e Brukselit

kanë thënë se ai nuk është i mjaftueshëm, duke vlerësuar se në të ka tone politike, dhe se nga Kosova nevojitet një raport i hartuar prej sistemit të drejtësisë. Autoritetet e Kosovës e kanë kritikuar disa herë Prokurorinë e Shtetit që ende nuk ka dalë me një raport për ngjarjet në Banjskë dhe nuk ka ngritur ndonjë aktakuzë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në anën tjetër, i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës që të mos ndërhyjë në punët e sistemit të drejtësisë, duke pretenduar se deklaratat e pushtetit janë tendencioze.

### Pse nuk i kryen BE-ja hetimet e veta?

Brukseli pohon se nuk ka mandat për një gjë të tillë. Nga BE-ja kanë thënë që sulmi ka ndodhur në territorin e Kosovës dhe se autoritetet atje janë kompetente. Kur kanë folur publikisht, zyrtarët e BE-së e kanë cilësuar sulmin në Banjskë terrorist. Por, në Raportin e Progresit të BE-së për vitin 2023,

në pjesën për Serbinë, sulmi në Banjskë përshkruhet se është kryer vetëm prej "individëve të armatosur rëndë".

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, nuk ka kthyer përgjigje për pyetjen e "Radios Evropa e Lirë" se pse blloku evropian ende nuk ka marrë ndonjë vendim për këtë rast. Në të kaluarën, ai e ka përsëritur disa herë që janë në pritje të raportit përfundimtar nga Kosova.

Parlamenti Evropian ka kërkuar ndëshkimin e Serbisë, mirëpo diçka e tillë është në dorën e Këshillit dhe të Komisionit Evropian.

Alejandro Esteso Perez, analist dhe studiues i politikave të Ballkanit dhe zgjerimit të BE-së, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se BE-ja nuk dëshiron ta vendosë Serbinë përpara pasqyrës.

"Nuk dëshiron të rrezikojë një reagim potencial të Vuçiqit, qoftë duke u afruar me Rusinë apo Kinën - që ai veçse po e bën - dhe e kupton që pa Serbinë nuk mund të ketë dialog Kosovë - Serbi", ka thënë Perez.

Ndërkaq, analisti Vogel ka thënë se ka dëgjuar prej ligjvënësve në BE që Serbia kritikohet nëpër biseda private. Por, sipas tij, "nëse diçka nuk thuhet publikisht, është sikur të mos ishte thënë fare".

### Çfarë masash do të duhej të merreshin ndaj Serbisë?

Vogel ka përmendur dy masa, që për të janë minimumi: Masa të

ngjashme me ato që i janë vënë Kosovës pas rritjes së tensioneve në veri në majin e vitit 2023.

Një deklaratë të qartë prej udhëheqësve perëndimorë që incidenti do të hetohet në hollësi dhe që Vuçiqi duhet të heqë dorë publikisht prej çfarëdo aktiviteti ushtarak afër Kosovës.

Analisti Perez, ndërkaq, ka vlerësuar se duhen të tjera masa: Nisja e menjëhershme e një hetimi të pavarur.

### Masa ekonomike

Masa që shënjojnë individët - ngrirje pasurish, ndalesa në udhëtime. Burimet në Bruksel kanë vlerësuar se BE-ja e përdor mosvendosjen e masave ndaj Serbisë "për t'i bërë presion" Beogradit për procese që dëshiron t'i çojë përpara. Megjithatë, Serbia vazhdon të mos e koordinojë politikën e saj të jashtme me atë të BE-së. Mossankcionimi i Rusisë për luftën e nisur në Ukrainë është vetëm një prej shembujve.

A do të ketë ndikim në Kosovë kjo qasje e BE-së? Perez beson që po. "Jam i befashuar prej përpjekjeve aq të vogla të BE-së për ta kuptuar situatën e Kosovës. Nëse nuk ka lëvizje edhe në muajt e ardhshëm, besimi i popullatës në të do të zvogëlohet dhe ata do të jenë edhe më të pashpresë sesa tani", thotë ai.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në vitin 2022 dhe aktualisht ka të nënshkruar vetëm Marrëveshje për Stabilizim-Asociim me bllokun evropian.

## PSD-ja kërkon nga kryetari i Vetëvendosjes t'i largojë konservatorët nga partia

**PRISHTINË, 8 MARS** - Partia Socialdemokrate (PSD) ka realizuar një aksion simbolik për nder të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Në këtë aksion aktivistët e kësaj partie kanë shkruar një parullë, duke i kërkuar kryeministrit Albin Kurti t'i largojë nga Vetëvendosja konservatorët. "Dorëzimi para konservatorizmit nuk tregon për forcën e grupeve të tilla, por kalkulum të qeverisë përmes partisë. Diversiteti është kthyer

në alibi për bashkekzistencë të kundërtave, brenda të njëjtit subjekt. Ata i thonë demokraci, por në të vërtetë paraqet koalicion me konservatorizmin dhe patriarkalizmin. E si mund të pritet ndryshe nga një model i politikës që udhëheq përmes figurës së njëshite? Ankesat se si nuk po ju dëgjojnë deputetët nuk janë bindëse nëse jeni të heshtur para tyre. Për më tepër që ne e dimë disiplinën brenda partisë tuaj kur preken kornizat politike. Apo, mbase, kjo është

shenjë se si mbështjellësi politik e ideologjik i juaji ka material konservator tashmë, dhe ruajtja e asaj çfarë keni arritur është synimi, përtej kauzave. Propozimi i ligjeve, por braktisja e debatit publik për ato, na lë ta kuptojmë se ju po rriteni duke mirëmbajtur dhe shpesh ushqyer rryma të dëmshme për shoqërinë dhe gratë në vëçanti. Kryeministër, kryeji punët e shtëpisë! Largoji konservatorët prej partisë!", ka thënë lideri i PSD-së, Dardan Molliqaj.





# Thirrje për barazi dhe drejtësi për gratë në Kosovë

Festa e 8 Marsit në Kosovë është shënuar me një marsh në Prishtinë, në të cilin janë kërkuar më shumë të drejta për gratë. Aktivistët për të drejtat e grave kanë thënë se gratë vazhdojnë të diskriminohen në të gjitha fushat, veçmas në punësim. Ndërsa liderët institucionalë janë zotuar se do të punojnë për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri

**PRISHTINË, 8 MARS** - Me thirrjet "Sot marshojmë, përditë luftojmë", "Drejtësi për gratë e vrara", "Drejtësi për gratë e gjalla", "Punë për mu çfarë pune du", "Edhe sa thirrje të humbura", "Poshtë prokuroria patriarkale", "Poshtë homofobia", "Trupi jem, e drejta jem", e slogane të ngjashme, aktivistë dhe qytetarë kanë marshuar në rrugët e Prishtinës me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

Marshi i përvitshëm është organizuar nga kolektivi "Marshojmë s'festojmë", duke bërë thirrje për barazi dhe drejtësi për gratë.

Qytetarët e kanë nisur marshin e tyre nga sheshi "Zahir Pajaziti", drejt ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke bërë thirrje për drejtësi për gratë e vrara në Kosovë dhe për mbrojtjen e grave që janë viktimat e dhunës në familje.

Protesta të ngjashme janë mbajtur edhe në vitet e kaluara në Kosovë në Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Nga Rrjeti i Grave të Kosovës kanë thënë se as këtë 8 mars gratë nuk do të festojnë, por do të marshojnë "për të drejtat e grave dhe vajzave: të drejtën në punë pa diskriminim, të ecim pa u ngacmuar, pa frikë e dhunë, për jetë autonome, e pavarur dhe e fortë". Aktivistët për të drejtat e grave kanë thënë se gratë diskriminohen sa i përket punësimit dhe, po ashtu, kërkojnë më shumë siguri për gratë në ambientet publike dhe private.

Nga viti 2010 deri në nëntorin e vitit 2023 në Kosovë janë vrarë 55 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në disa raste, kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

## Liderët institucionalë dhe partiakë urojnë gratë për 8 Mars

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe të partive politike i kanë uruar gratë me rastin e 8 Marsit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se në "Ditën Ndërkombëtare të Gruas shënojmë arritjet e grave dhe vajzave dhe përpjekjet e jashtëzakonshme të tyre në

Kosovë dhe kudo në botë për të drejta të barabarta". "Sot kujtojmë të gjitha ato gra dhe vajza që nuk janë më në mesin tonë, e të cilat u shndërruan në simbol rezistence, lufte dhe angazhimi për liri dhe barazi. Forca, qëndrueshmëria dhe zelli juaj i pasqyruar për emancipim të vazhdueshëm, zhvillim e barazi, qëndron fort në themelet e Republikës sonë. Sot, nesër dhe çdo ditë, me ju dhe për ju!", ka thënë Osmani.

Ndërsa kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se Dita e Gruas vijon ta zgjojë ndërgjegjen e gjithsecilit për të ecur në rrugën drejt barazisë. "Gruas i duhet sfera publike, por sferës publike i duhet gruaja edhe më shumë, sepse pa gruan ajo nuk mund të jetë e mirëfilltë. E në anën tjetër, domeni socio-ekonomik pa



gruan e integruar plotësisht, ngelet vetëm një rend ku menaxhohet dhuna apo shtypja, e përmasave dhe natyrave të ndryshme, herë duke bërë bujë e më shpesh në heshtje. Të përfitojmë nga rasti që na ofron 8 Marsi, duke e dëgjuar atë si thirrje për reflektim dhe angazhim të pandërprerë, deri në emancipim të plotë, i cili na përmbush të gjithëve", ka thënë Konjufca.

Në anën tjetër, kryeministri Albin Kurti e ka quajtur Kosovën shtet

feminist, ndërsa ka përmendur edhe shtesat për lehonat e fëmijë. "Synimi ynë për barazi dhe drejtësi nuk ka alternativë, politikat feministe po e ruajnë demokracinë. Ky është edhe shteti për të cilin punojmë çdo ditë, demokrat po, por edhe feministë. Këtë e dëshmojmë edhe me politikat tona. Me secilin dikaster kemi marrë masat për lehtësimin e jetës të vajzave dhe grave. Ne qeverisim me parime socialdemokrate dhe

qasja e tillë ka qenë edhe me politikatat tona për qytetarët. Filluam me shtesat për lehonat dhe për fëmijë. Qeveria jonë ka qenë e përkushtuar që ndryshimet për barazi sociale ta nisë edhe në sektorin publik. Fuqizimi i pozitës së grave në shoqëri është një ndër ndryshimet thelbësore që qeveria jonë e ka që në fillim të mandatit", ka thënë Kurti.

Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ua ka uruar të gjitha grave festën e 8 Marsit. Ai ka thënë se "angazhimi dhe solidariteti për t'i përforcuar zërat e grave, duke mbrojtur të drejtat e tyre dhe duke punuar pa u lodhur për të krijuar një shtet ku çdo grua vlerësohet, respektohet dhe fuqizohet për ta përmbushur potencialin e saj - është obligim dhe detyrë e secilit prej nesh".

"Sot, derisa shënojmë arritjet dhe qëndrueshmërinë e jashtëzakonshme të grave të vendit tonë, është tejet e rëndësishme që të mos përkufizojmë të drejtat e tyre vetëm në simbolikat e 8 Marsit. Në vend të kësaj, le ta shfrytëzojmë këtë ditë si mundësi për t'u ripërkushtuar ndaj luftës së vazhdueshme për barazi dhe drejtësi, jo vetëm sot, por çdo ditë të vitit - dhe po, edhe në 365 ditët e këtij viti. Angazhimi dhe solidariteti për t'i përforcuar zërat e grave, duke mbrojtur të drejtat e tyre dhe duke punuar pa u lodhur për të krijuar një shtet ku çdo grua vlerësohet, respektohet dhe fuqizohet për ta përmbushur potencialin e saj - është obligim dhe detyrë e secilit prej nesh. Urime 8 Marsi!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka uruar në mënyrë të veçantë nënën dhe gruan e tij. Haradinaj ka publikuar në "Facebook" një fotografi me nënën dhe gruan, duke kërkuar përkrahje dhe barazi për gratë. "Shumë dashuri, përkrahje e barazi! Urime 8 Marsi - Dita Ndërkombëtare e Gruas!", ka shkruar Haradinaj.



## Aktivistja Gosalci kërkon nga qeveria t'i shpallë heroina gratë që kanë lindur dhjetë fëmijë

Poetja dhe aktivistja Shefqete Gosalci i ka uruar të gjitha gratë në Kosovë me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Krahas urimit, Gosalci i është drejtuar Qeverisë së Kosovës me një propozim, duke kërkuar të japë pagë mujore për gratë që kanë lindur dhjetë fëmijë. Po ashtu, ajo ka propozuar që këto

gra të shpallen heroina. "Urime 8 Marsin të gjitha grave të Kosovës! Me rastin e 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Grave, që luftojnë për sa më shumë të drejta, liri dhe barazi! I drejtohem Qeverisë së Republikës së Kosovës me këtë PROPOZIM: Për gratë e Kosovës të cilat kanë lindur 10-të (dhjetë),

e më shumë fëmijë, duke e ruajtur Kombin të ri, me vendim të qeverisë të shpallen HEROINA dhe të gëzojnë një pagë mujore dinjitoze. Kontributi i këtyre nënave është i paçmuar, dhe ATO meriton të vlerësohen dhe nderohen nga institucionet e shtetit", ka shkruar Gosalci në "Facebook".



## PDK-ja: Nuk do të lejojmë që të kalojë Ligji për Zyrtarët Publikë

PRISHTINË, 8 MARS - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka reaguar pasi Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin për Zyrtarët Publikë. Përparim Gruda nga subjekti më i madh opozitar ka thënë se qeveria nuk e ka marrë parasysh një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese për këtë ligj. Në këtë kontekst, ai ka thënë se PDK-ja nuk do ta lejojë këtë arbitraritet.

“Qeveria ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në kundërshtim me Aktgjykimin në rastet KO 216/22 dhe KO 220/22 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Qeveria ka lënë në fuqi dispozitat që

përcaktojnë se pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të jenë me mandat katërvjeçar, në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte përcaktuar se emërimet në këto pozita para hyrjes në fuqi të Ligjit bazë për Zyrtarë Publikë nuk i nënshtroheshin emërimit me mandat, por mbajnë vendet e tyre të punës sipas aktemërimeve që kanë pasur. Kjo është një fazë e re e shkeljes së Kushtetutës së Kosovës nga qeveria, ku edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dispozitat jokushtetuese përfshihen në ligje. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nuk do ta lejojë këtë arbitraritet”, ka thënë Gruda.



## Tahiri për miratimin e Projektligjit për Zyrtarët Publikë: Ky është sulm brutal kundër administratës shtetërore



PRISHTINË, 8 MARS - Shefi i grupit parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës në një mbledhje elektronike ka miratuar Projektligjin për Zyrtarët Publikë.

Ai ka bërë me dije se ky projektligj është miratuar pa konsultim publik dhe pa marrë parasysh rekomandimet e BE-së e të shoqërisë civile.

Tahiri ka shkruar në “Facebook” se ky është një sulm brutal i qeverisë kundër administratës së shtetit! “Qeveria e Kosovës e ka në miratim Ligjin për Zyrtarët Publikë në mbledhjen elektronike. Ky Ligj u miratua pa asnjë ditë të konsultimit publik, pa përfshirjen e asnjë

rekomandimi të vetë zyrtarëve publikë dhe pa trajtimin e sugjerimeve të BE-së. Sot, me këtë ligj po kapet politikisht administrata e shtetit”, ka shkruar ai.

Ai ka përmendur disa nga problemet e projektligjit në fjalë. “1. Mungesa e konsultimit me palët e afektuara, që janë zyrtarët publikë. Kjo e bënë projektligjin pa legjitimitetin e nevojshëm. 2. Projektligji shkon kundër aktgjyimit të Gjykatës Kushtetuese, duke paraparë që nëpunësit që janë emëruar në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, të privohen nga e drejta ligjore e fituar me ligjin që ka qenë në fuqi kur janë emëruar. Projektligji i ri, duke i dhënë vetes efekt

retroaktiv, e cenon të drejtën ligjore të fituar të kësaj kategorie. Krejt kjo në kundërshtim flagrant me parimet e SIGMA-së dhe BE-së, si një detyrim që Kosova ka marrë me MSA-në, që RAP ta bëjë në koordinim me BE-në, të cilën gjë nuk po e bënë. 3. Ky projektligj shkel të drejtat e njeriut, pasi që bazohet në supozimin e paargumentuar se nëpunësit civilë nuk vlejné dhe se ata duhet të largohen masivisht nga puna, për të sjellë në ato pozita persona të dëgjueshëm për politikën në pushtet. Thjesht, është një hap në kapjen e administratës shtetërore, krahas edhe hapave që kjo qeveri ka ndërmarrë në kapjen e shtetit”, ka shkruar Tahiri.

## Ish-ministri Mehaj emërohet këshilltar i jashtëm i kryeministrit Kurti



PRISHTINË, 8 MARS - Ish-ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, është emëruar këshilltar i jashtëm i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Drejtori i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, Naim Rashiti, ka thënë se Mehaj është emëruar këshilltar i jashtëm i kryeministrit sikurse disa të tjerë që janë nëpër institucioneve qeveritare. “Po, është këshilltar i jashtëm si shumë të tjerë që

kemi për institucione”, ka thënë Rashiti për mediet vendore.

Në gusht të vitit të kaluar Mehaj kishte dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit.

Përmes “Facebook”-ut, ai kishte treguar se dorëheqjen e ka ofruar për arsye personale. “Sot, më 08 gusht 2023, në mirëkuptim dhe mirëbesim të plotë, me kërkesën time, Kryeministri Albin Kurti më ka liruar nga detyra e Ministrit të

Mbrojtjes të Republikës së Kosovës! Kjo kërkesë prej anës sime, ka ardhur për arsye familjare, për të cilat e kam njoftuar Kryeministrin Kurti, me kohë që më parë. Ai më falënderoi për punën time si dhe për të gjitha angazhimet e përbashkëta deri më sot, gjatë këtyre 29 muajve sa isha në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës”, kishte shkruar Mehaj.

## Shqiptari nominohet për ambasador të ShBA-së në Mal të Zi: U jam falënderues Bidenit dhe Blinkenit

UASHINGTON, 8 MARS - B. Bix Aliu, me kombësi shqiptare, është nominuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, për ambasador të Amerikës në Malin e Zi.

Aliu, që mban diplomë të bachelorit në fushën e mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, është shprehur i lumtur dhe falënderues për nominimin nga presidenti Biden. “U jam mirënjohës

presidentit dhe sekretarit Blinken për punën e tyre, besimin tek unë dhe shpresoj të fitoj besimin tuaj gjithashtu. Nëse konfirmohet, do të punoj ngushtë me ju për t'i avancuar interesat e ShBA-së në Mal të

Zi”, ka thënë ai para Senatit Amerikan.

Ambasadori Aliu më parë kishte shërbyer në Poloni, ndërsa flet gjuhën shqipe, maqedonase, polake, malazeze dhe serbo-kroate.





## Kosovës 'i duhet ligj për valutën'

**PRISHTINË, 8 MARS** - Kosova nuk ka ligj të veçantë me të cilin do ta përcaktonte valutën e saj kombëtare, por ka një urdhëresë administrative e cila e përcakton euron si valutë për pagesa. Në Kushtetutën e vendit, Neni 11, thuhet se si mjet pagese duhet përdorur "një valutë e vetme", por nuk përcaktohet cila.

Duke u thirrur në këtë nen, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka fuqizuar edhe një rregullore më 1 shkurt, e cila e specifikon euron si valutë të vetme për pagesat me para të gatshme në Kosovë.

Rrjedhimisht, dinari serb që përdoret në komunat me shumicë serbe në vend është ndaluar. "Radio Evropa e Lirë" ka pyetur BQK-në dhe Qeverinë e Kosovës se përse vendi nuk ka ligj për valutën dhe a po punohet në këtë drejtim, por nuk ka marrë përgjigje prej asnjërit institucion.

Ekspertët e çështjeve juridike dhe ekonomike kanë thënë se, në mungesë të një ligji specifik për valutën, rregullorja e BQK-së është "gabim në hapa".

Dokurdo, sipas tyre, Kosovës do t'i duhet ky ligj. Pas përfundimit të luftës më 1999, kur në Kosovë është

vendosur administrata e Misionit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK, autoritetet e saj, përmes një rregulloreje, e përcaktuan markën e atëhershme gjermane si valutë për pagesa në Kosovë. Deri atëherë përdorej dinari jugosllav.

Rreth dy vjet më vonë, përkatësisht në dhjetor të vitit 2001, UNMIK-u, përmes një urdhërese administrative (2001/24), e përcaktoi euron si valutë që do të përdorej në Kosovë nga 1 janari i vitit 2002.

Në të njëjtën kohë, edhe 18 shtete që asokohe ishin anëtare të Bashkimit Evropian, e lëshuan në përdorim euron, duke i zëvendësuar njësitë e tyre valuto. Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, ka thënë se urdhëresa administrative e UNMIK-ut është bazë ligjore për përdorimin e euros si mjet pagese në Kosovë. Kur kjo është miratuar, ka thënë ai, ka pasur një "pajtim në heshtje" midis UNMIK-ut, partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës dhe Bankës Qendrore Evropiane, dhe nuk është kaluar nëpër procesin e miratimit të kriterëve.

"Çdo rregullore e UNMIK-ut



mbetet në fuqi deri në rastin kur ajo nuk shfuqizohet me një ligj të veçantë", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Ndërsa Mejdin Bektashi, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, është pajtuar se mungesa e një ligji të veçantë për valutën e Kosovës nuk e bën të paligjshëm përdorimin e euros, megjë për të ekziston urdhëresa e UNMIK-ut.

Por, ai ka thënë se mungesa e tij shkakton telashe teknike për Bankën Qendrore të Kosovës kur ajo nxjerr akte nënligjore - si rregullorja e fundit që e përcakton euron si valutë të vetme për pagesa

- pa pasur ligj. "Së pari duhet të aprovohet ligji për valutën e Republikës së Kosovës. Atë ligj duhet ta sponsorizojë Banka Qendrore [e Kosovës], ta aprovojë Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe, pastaj, pas një periudhe transitorie - disa muaj, një apo më shumë vite - të zbatohet ligji dhe jo akti nënligjor, që është (në këtë rast) rregullorja e BQK-së", ka thënë Bektashi, njëherësh ish-anëtar i Bordit të BQK-së.

Sipas Miftarajt, rregullorja që e ndalon dinarin ka qenë e panevojshme, "marrë parasysh bazën juridike që del nga urdhëresa e UNMIK-ut për përdorimin e

euros si valutë të vetme për pagesë". Kjo urdhëresë, ka thënë ai, ka mundur të zbatohet edhe pa rregulloren e BQK-së, të cilën ai e interpreton si veprim me prapavijë politike. "Nëse kanë dashur ta zbatojnë, është dashur që këtë ta bëjnë institucionet për zbatimin e ligjit, edhe pa vendimin e BQK-së. Por, t'u thuash (zyrtarëve të qeverisë) që zbatojnë një rregullore të UNMIK-ut, u dhemb koka, kështu që kanë dalë me këtë (rregulloren) e BQK-së", ka thënë Miftaraj.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka këmbëngulur se BQK-ja është institucion i pavarur dhe si i tillë merr vendime. Megjithatë, në disa raste ka theksuar se rregullorja në fjalë nuk mund të anulohet. Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar që të shtyhet zbatimi i saj, derisa komuniteti serb në Kosovë, i cili me vite ka pranuar pagesa të ndryshme në dinarë nga Serbia, të përshtatet me praktikën e re.

Por, sipas Kurtit, rregullorja nuk i ndalon pagesat nga buxheti i Serbisë - ato vetëm duhet të bëhen në euro. Sipas BQK-së, arsyeja kryesore për këtë rregullore ka qenë integriteti financiar.

## Deputeti Lushtaku kërkon lejimin e importit të veturave më të vjetra se 10 vjet, Oda Amerikane kundër

**PRISHTINË, 8 MARS** - Në tryezën e diskutimit rreth nismës ligjore lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete, iniciuar nga deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku, përfaqësues të Odës Ekonomike Amerikane dhe ekspertë të komunikacionit ishin kundër heqjes së kriterëve për importin e veturave më të vjetra se dhjetë vjet, për arsye, siç janë shprehur ata, të ruajtjes së mjedisit në vend.

Edhe pse deputeti Lushtaku gjatë arsytimit të kësaj nisme ligjore ka theksuar se në asnjë vend të Evropës nuk ka kufizim të importit të veturave me dhjetë vjet, ai ka thënë se në vendet evropiane ka



vetëm standard të "Euro diesel 4", duke shtuar se janë edhe për ruajtjen e ambientit në Kosovë.

"Te pjesa e vjetërsisë së veturave në

Kosovë sigurisht që është e vjetër dhe besoj që kjo do t'u kishte mundësuar qytetarëve që nëse e ka një veturë 2005, ta blejë një veturë

të vitit 2007-2008 për shkak të standardit ekonomik, por gjithmonë duke ruajtur ambientin, sepse edhe fokusi im si deputet nuk është vetëm të kursehet xhepi i qytetarëve por, në të njëjtën kohë, të kemi një ambient ku edhe ne i rrisim familjet tona në Kosovë", ka thënë Lushtaku.

Në këtë tryezë janë trajtuar me fokus të veçantë nenet 44 dhe 63, ku përcaktohen kriteret për importin e veturave dhe ndërrimin e pronësisë.

Nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Vesa Sahatçiu, ka thënë se qëndrimi i kësaj ode mbetet që nuk mund të importohen vetura më të vjetra se dhjetë vjet për shkak

të ruajtjes së ambientit.

Edhe përfaqësues nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare kanë pasur mendim të njëjtë sikur ajo Amerikane. Ndërsa për këtë qëndrim të odave, deputeti nga PDK-ja, Lushtaku, ka sfiduar këto oda se nëse ka ndonjë shtet në Evropë, do ta tërheqë këtë nismë ligjore. Kurse eksperti i komunikacionit, Muhamed Krasniqi, ka thënë se e kupton shqetësimin e deputetit Lushtaku, por ka thënë se Kosova nuk duhet të bëhet deponi lëvizëse e mjeteve motorike.

Iniciativa e Lushtakut ka gjetur përkrahje nga Shoqata e Kontrolleve Teknike në Kosovë.

## Regjistrimi i popullsisë, 10 mijë euro shpërblim kush e qëllon numrin e saktë

**PRISHTINË, 8 MARS** - Regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të fillojë pas 26 ditësh. Nga data 5 prill deri më 17 maj në dyert tona do të trokasin zyrtarë të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për t'i marrë të dhënat tona si banor në Republikën e Kosovës.

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), të premten, në një konferencë për medie, ka paraqitur në detaje planin për regjistrimin e popullsisë. Sipas zyrtarëve të kësaj agjencie, cilido qytetar që ia qëllon se sa do të dalë në fund numri i popullsisë në Kosovë, do të fitojë një çmim prej 10 mijë eurove.

"Është një lojë shpërblyese, ai që e di se sa do të dalë popullsia në

Kosovë, do të fitojë një çmim prej 10.000 eurosh. Por na vyen saktësia sa, rrethi 'pikado', kush e qëllon, shpërblimi do të jetë deri në 10 mijë euro", ka thënë Avni Kastrati, menaxher i Regjistrimit të Popullsisë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK).

Si një problematikë që shpesh është diskutuar vitin e kaluar, duke qenë se ishte paraparë që të ndodhte si proces, por u shty deri në këtë vit, Kastrati ka dhënë detaje rreth formës së regjistrimit të popullsisë sivjet. Ai ka thënë se regjistrimi do të jetë "derë më derë". "Projekti i regjistrimit të popullsisë në Kosovë, në bazë të vlerësimeve Kosova dhe ASK është e përgatitur për regjistrimin e

popullsisë në datë dhe muaj të caktuar. Na kanë mbetur 27 ditë prej sot deri te regjistrimi i popullsisë. Janë tri shtete që regjistrojnë popullsitë këtë vit: Moldavia, Gjeorgjia dhe Kosova. Shtetet e tjera regjistrimin e kanë bërë duke u bazuar në kombinim të metodave të ndryshme. ASK është e gatshme të bëjë regjistrimin e popullsisë. Deri tani ka pasur shumë sfida, por nuk do të thotë që ka mbaruar regjistrimi i popullsisë. Ndoshta do të jetë regjistrim i kombinuar. Besoj se jemi në rrugë të mirë sepse kemi analizuar databazat që kemi në dispozicion. E dimë të gjithë që është një projekt që u jep shumë të dhëna institucioneve", ka thënë



Kastrati.

Kryeministri Albin Kurti, në një mbledhje të mbajtur më 22 nëntor të vitit të kaluar, pati hedhur kritika në adresë të menaxhmentit të ASK-së, duke thënë se "procesi i menaxhimit të regjistrimit të popullsisë, nuk ishte mirë". Pa iu referuar kësaj deklarate, por duke arsyetuar shtyrjen e procesit, Avni Kastrati i ASK-së thotë se disa nga faktorët ishin "moti në nëntor" dhe "ngjarjet në veri". "Qeveria e

Kosovës e ka shtyrë përsëri edhe për disa muaj procesin e regjistrimit të popullsisë, që tani parashihet të fillojë në prillin e vitit të ardhshëm", ka thënë Kastrati.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë është bërë në vitin 2011, ndërsa regjistrimi që është dashur të bëhet në vitin 2021, është shtyrë për shkak të pandemisë Covid-19. Sipas regjistrimit të bërë më 2011, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1.8 milion. Por, në këtë regjistrim nuk ishin përfshirë banorët e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës - Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut - pasi që në atë kohë ata kishin refuzuar procesin.



# Lëvizja e guximshme e grave britanike, për të drejtën e votës

Nga: Lindsay BAKER / BBC  
Përkthimi: Telegrafi.com

Lilian Lenton e dinte – që herët në jetën e saj – se si ndihej për pabarazinë. Si fëmijë ishte “shumë e mërziur për dallimet midis përparësive që kishin burrat dhe djemtë dhe asaj që kishin vajzat”, ka thënë ajo për BBC në vitin 1955. “Të gjithë e donin djalin ... dhe, kjo më acaroi, jashtëzakonisht shumë. Më pas, kur dikush u rrit duke parë dallimet në mundësitë që kishin burrat, epo sigurisht që kjo e rriti atë ndjesi”, i tha ajo intervistuesit. Ajo lindi në Lestër vitin 1891, si më e madhja nga pesë fëmijët; babai i saj ishte marangoz dhe nëna e saj shtëpiake. Pasi u trajnuar si balerinë, si e re mori pjesë në një takim të hapur të Unionit Social dhe Politik të Grave (WSPU), ku folësja shpjegoi se “të çmendurit, kriminelët, të varfrit dhe gratë nuk mund të votojnë”. U bashkua

bërë grevën “për t’u liruar, me arsyetimin se nuk kishin të drejtë të burgosnin gratë për shkelje të ligjeve të krijuara nga burrat”.

S’kaloi shumë kohë dhe gratë u penguan dhe ushqeheshin me forcë me urdhër të autoriteteve të burgut – një procedurë brutale dhe çnjerëzore. Në intervistë, Lentoni tingëllon e përhumbur nga kujtimi. “Procesi i ushqyerjes me forcë ishte vërtet shumë i pakëndshëm”, thotë ajo. “Nuk më pëlqen të flas për këto gjëra ... Nuk ua kam thënë kurrë njerëzve”.

Megjithatë, vazhdoi të përshkruante në detaje procesin barbar i cili – në rastin e saj – e çoi në sëmundjen e rrezikshme me pleurit dhe pneumoni të dyfishtë, të shkaktuara nga grimcat e ushqimit që hynë në mushkëri.

Kur u sëmur rëndë, u lirua nga burgu, por rasti shkaktoi zemërim në publikun e gjerë. Ministria e Brendshme mohoi që Lentoni ishte ushqyer me forcë, duke pretenduar se sëmundja e saj ishte



lirua për shkak të efekteve të këqija të grevës së urisë.

Kur doli nga burgu, Lentoni “u duk si person normal” dhe “përpiqej t’u shpëronte detektivëve”, tha ajo për BBC-në. “Sa herë që isha jashtë burgut, qëllimi im ishte të digjia dy ndërtesa në javë. Qëllimi ishte krijimi i gjendjes absolutisht të pamundur në vend, për të dëshmuar se ishte e pamundur të qeverisesh pa pëlqimin e të qeverisurve.”

Më vonë ajo mori një medalje për trimëri nga WSPU-ja.

Në vitin 1914, me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, WSPU-ja pezulloi fushatën militante dhe u përqendrua në përpjekjet e luftës. Gjatë luftës gratë morën punët që tradicionalisht kryenin burrat, duke dëshmuar se mund t’i bënin po aq mirë, duke ndihmuar kështu që të heshtet çdo argument kundër të drejtave të grave për të votuar.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1918, u miratua Akti i Përfaqësimit të Popullit, duke e lejuar votën për gratë që plotësonin disa kriterë pronësie, ose gratë e martuara, apo ato mbi 30 vjeçe. Lentonit nuk i bëri përshtypje. Tha: “Personalisht nuk votova për një kohë shumë të gjatë, sepse nuk kisha as burrë, as mobile, megjithëse isha mbi 30 vjeçe”. Vetëm në vitin 1928 u arritën të drejtat e barabarta për votim.

Taktika e sufrazheteve ishte të kërkoni – jo të luteni – për të drejtat. “Vepra jo fjalë”, ishte motoja e WSPU-së, e krijuar në vitin 1903. Themeluesja Emmeline Pankhurst, e cila kishte qenë anëtare e një grupi të sufrazhisteve të Mançesterit, kishte vendosur se, për të siguruar të drejtën e votës, ishte koha për veprim të drejtpërdrejtë nga gratë e klasës punëtore.

Politikanët u dëshpëruan nga

shtrirja e protestave në atë kohë dhe kjo “u konsiderua si vërtet e pakëndshme”, ka thënë më 2018, për BBC-në, autorja Elizabeth Crawford. Gjithçka ndryshoi më 1905, kur Christabel Pankhurst dhe Annie Kenney u akuzuan për obstrukcion meqë ndërprejnë mbledhjen e Partisë Liberale. Dy gratë zgjodhën të shkonin në burg, në vend që të paguanin gjobën, dhe ky veprim u bë frymëzim për grupin.

“Ideja e militantizmit u rrit me kalimin e viteve”, ka thënë Crawford. “Kjo nuk u miratua kurrë haptazi nga kreu, por nuk i dënuan ato. Pak a shumë thanë, ‘bëjeni atë që duhet bërë’”.

Edhe pse e dominuar nga gra të arsimuara dhe të klasës së mesme, lëvizja e grave sufrazhete përfshinte gjithashtu gratë me më pak pasuri. Në Procesionin e Madh të vitit 1910, në demonstratën e madhe në Londër të organizuar nga WSPU-ja, gazeta Votes for Women shënoi se “ka pasur gjithashtu punëtore të djersitura me rroba të varfra dhe qepëset të cilat çdo ditë luftojnë me urinë”. Përpjekjet për të mbledhur mbështetje për procesionin, paraprakisht u bënë në takimet me punëtorët e lavanderisë në veri të Londrës, si dhe duke kërkuar gratë në “fabrikat dhe lavanderitë” të Londrës jugore.

Sufrazhetja nga Mançesteri, Elizabeth Dean, gjithashtu u intervistua nga BBC-ja në vitin 1978. Ajo e bëri të qartë se jo të gjitha koleget e saj aktiviste ishin me arsim të lartë dhe as të pasura. Për të dhe të tjerat, fitimi i së drejtës për të votuar ishte pjesë e qëllimit më të gjerë për të shmangur të qenit thjesht “makineri për të lindur fëmijë”, si nëna e saj – e cila vdiq në fund të të ‘30-ave, pasi kishte tetë fëmijë. “Jo të gjitha gratë në lëvizjen sufrazhiste luftonin për diploma”, ka thënë ajo. “Nuk e kishim shansin për të marrë diplomën, se ishim gra që punonim dhe secila prej nesh kishte mendimet e veta private për atë që donte, atë që mendonte se ishte e drejtë dhe për atë që mendonte se ia vlen të luftojmë”. /Telegrafi/



Ishte e zakonshme ushqyerja me forcë e sufrazheteve – gjatë grevës së urisë



Pamje nga arrestimet a sufrazheteve

menjëherë, thotë ajo, dhe shpejt do të merrte pjesë në “paradat e posterëve” nëpër Londër.

Në mars të vitit 1912, ajo dhe anëtarët e tjera të armatosura me çekanë, morën pjesë në një fushatë të thyerjes së dritareve në Londër – dhe u burgos për dy muaj. Në korrik 1912, pas arrestimit të lideres së grupit, sufrazhetet iu kthyen zjarrvënies. Lenton dhe Olive Wharry kryen një sërë të sulmeve me zjarr dhe u arrestuan. Sulmet e tilla fillimisht ishin të rrezikshme për aktivistet, megjithëse ishin të kujdesshme që të mos e rrezikonin publikun.

Në burg, ajo, së bashku me shumë kolege të saj protestuese, e nisi një grevë urie. I tha BBC-së se e kishte

shkaktuar nga greva e urisë – një pretendim që u hodh poshtë nga dokumentet zyrtare që regjistronin ushqyerjen e saj me forcë. Zemërimi publik u intensifikua kur një kirurg i shquar i shkroi Times-it duke shprehur shqetësimet e veta etike.

Disa muaj më vonë, përsëri u arrestua për një sulm me zjarr që u krye në Donkaster bashkë me gazetarin lokal 18-vjeçar, Harry Johnson. Në të njëjtin vit, në Parlament u miratua akti i cili u bë i njohur si Akti i Maceve dhe Miut, sipas të cilit çdo grua e burgosur që ishte në grevë urie, duhej liruar kur sëmuret dhe më pas të riarrestohet pasi të jetë shëruar. Lentoni u arrestua disa herë dhe disa herë u



Një pankartë gazete që deklaronte rishfaqjen e Lilian Lentonit e cila kërkohet nga policia



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Dy derbi në Superligë

## “Epoka e re”

**PRISHTINË, 8 MARS** - Xhironja e 24-t në Superligën e Kosovës në basketboll do të sjellë dy ndeshje derbi. Derbi i parë është zhvillohet në “Minatori” mes fituesit të Kupës dhe Superkupës, Trepçës dhe kampionitëve aktual, Pejës. Të dyja këto skuadra luajnë për fitore në këtë ndeshje. Trepça është në pozitën e parë dhe ka 21 fitore e dy humbje, ndërsa verdhezinjtë 17 fitore e gjashtë humbje. Takim shumë i vlefshëm edhe ai

ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Vëllaznimit. Prizrenasit duan të jenë pjesë e “play-off”-it, ku renditen në vendin e shtatë me shtatë fitore e 16 humbje, ndërsa kuqezinjtë në vendin e pestë me dhjetë fitore e 13 humbje. Të dielën do të përballen Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina, në duelin për vendin e tretë. Të dyja skuadrat kanë grumbulluar nga 14 fitore e nëntë humbje dhe takimi është shumë i rëndësishëm para garave përfundimtare. Java e 24-t mbyllet me takimin në mes të Bashkimit dhe Istogut.

Prizrenasit janë në vendin e gjashtë me tetë fitore e 15 humbje, ndërsa istogasit janë në vendin e fundit me një fitore e 22 humbje. Fitoren e vetme e kanë ndaj prizrenasve.

### SUPERLIGA - Java 24

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Trepça - Peja  
19:00 Proton Cable Prizreni - Vëllaznimi

**Të dielën takohen:**  
17:00 Golden Eagle Ylli-Sigal Prishtina  
19:00 Bashkimi-Istogu



## SHKURT

### Eliminohen Fatjona Kasapi dhe Flaka Loxha

Xhudistet e Kosovës, Fatjona Kasapi dhe Flaka Loxha, kanë përfunduar garat në Grand Prix Upper që po mbahet në Linz të Austrisë. Në kuadër të kategorisë deri në 57 kilogramë, Loxha dhe Kasapi janë ndalur qysh në raundin e dytë të kësaj gare. Kasapi raundin e parë e kaloi pa luftë, kurse në të dytin u mposht nga xhudistja Marica Perisiq. Ndërkaq, Loxha në raundin e parë e mposhti xhudisten nga Guinea, kurse në të dytin u mposht nga xhudistja belge, Mina Libeer. Pas këtyre humbjeve përfundon edhe gara për Flaka Loxhan dhe Fatjona Kasapin në Grand Prix Upper Austria.

### Zhegrova në formacionin e javës të Ligës së Konferencës

Ylli i Kosovës, Edon Zhegrova, ka përfunduar si pjesë e formacionit të javës në Ligën e Konferencës pas paraqitjes së mirë në ndeshjen e Lilles ndaj Sturm Grazit. Edon Zhegrova me skuadrën e tij, Lille, fituan në udhëtim te Sturm Grazi me rezultat 3-0. Një nga golat e ndeshjes u shënuar pikërisht nga ylli i “Dardanëve”, i cili shënoi një gol të bukur në minutën e 71-të. Paraqitja e mirë në këtë ndeshje bëri që Zhegrova të vlerësohet lart nga faqja e specializuar e statistikave, “SofaScore”. Zhegrova mori notën 8 dhe përfundoi në formacionin më të mirë të javës në Ligën e Konferencës.

Formacioni: Jedlicka, Djiku, Ribeiro, Hato, Milson, Hezze, Madragora, Tsunemoto, Zhegrova, Petkoviq, Daviq.

### Superliga e hendbollistëve rikthehet me derbi të madh

Në fundjavë fillon stinori pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll (femrat). Edicioni pranveror nuk ka nisur deri më tani për shkak të aktiviteteve ndërkombëtare të përfaqësuesve U18 dhe U16. Në radhë është xhironja e 12-të kampionale, ndërsa e gjithë vëmendja do të jetë te derbi i madh në mes të Istogut dhe Samadrexhës. Kjo ndeshje zhvillohet të dielën prej orës 18:00 në Banjë. Bëhet fjalë për dy prej skuadrave të organizuara mirë, që synojnë trofe këtë edicion. Të dyja skuadrat kanë bërë ndryshime në fondin e lojtareve dhe pritet të jenë edhe më të forta në vijim të kampionatit. Kampioni aktual, Istogu, është i dyti në tabelë me 20 pikë. Samadrexha është e treta me 18 pikë. Në tabelë udhëheq Ferizaj me 22 pikë. Të dielën janë edhe ndeshjet Ulpiana - Kastrioti (14:00) dhe Vushtrria - S hqiponja (16:00). Të shtunën është takimi në mes të Prishtinës dhe Jusuf Gërvallës, që fillon në orën 16:30.

## Sot zhvillohen tri ndeshje në elitën e futbollit

**PRISHTINË, 8 MARS** - Ndeshje interesante do të sjellë java e 24-t në Superligën e futbollit, pasi klubet luftojnë për titullin e kampionit, daljen në Evropë dhe për mbijetesë në elitë. Ndeshja kryesore konsiderohet ajo në mes të Dritës dhe Prishtinës. Gjilanasit kërkojnë tri pikë në mënyrë që të ruajnë hapin në

garën për titull të kampionit me Ballkanin dhe Llapin, kurse pikë kërkojnë edhe kryeqytetasit të cilët po luftojnë për vend që dërgon në Evropë. Llapi - Gjilani është një tjetër ndeshje interesante derisa hiç më lehtë nuk do ta ketë as Ballkani që ndeshet me Malishevën. Në zonën e rrezikshme bie në sy

përballja në mes të Lirisë dhe Feronikeli 74, skuadra këto që ‘luftojnë’ me të gjitha forcat për ta siguruar ekzistencën në elitën e futbollit të Kosovës. Të shtunën takohen: Drita-Prishtina, Dukagjini-Fushë-Kosova, Llapi-Gjilani. Të dielën takohen: Ballkani-Malisheva, Liria-Feronikeli 74.





## Fitore bindëse e Besës ndaj Trepçës

**PREJË, 8 MARS** - KH Besa Famgas ka nisur furishëm ndeshjen ndaj Trepçës dhe në fund ka fituar me rezultat bindës. Besa e Trepça u përballën të enjten mbrëma në "Karagaçi" në kuadër të xhiros së 19 të Superligës së Kosovës në

hendboll. Besa fitoi me rezultatin e lartë 41:25. Ekipi pejan nisi me seri prej 9:1. Pjesa e parë përfundoi 21:10. Në pjesën e dytë vendasit vazhdimisht mbajtën epërsi të lartë. Olsi Mulaj ishte më efikas te

kampionia aktuale me 12 gola. Nga 5 i kishin Igor Chiesliov e Antonio Vozila. Te mitrovicasit më efikas ishte Muhamet Dubovci me 8 gola. 6 i realizoi Shpëtim Mehmeti, ndërsa 4 i kishte Yassine Henahen. Besa

Famgas është e dyta në tabelë me 30 pikë. Trepça mbetet e treta me 24 pikë, ndërsa ka një ndeshje më pak të luajtur. Skuadra mitrovicase aktualisht ka fond shumë të limituar lojtarësh, por "xehetarët" po



punojnë për të afruar disa lojtarë të tjerë.

## Hamiltoni: Verstappeni është në listën e ngushtë të Mercedesit

**STUTTGART, 8 MARS** - Lëvizja tjetër e madhe në Formula 1 do të ishte me kalimin e pilotit të Red Bullit Max Verstappen te Mercedesi, me Lewis Hamiltonin që do t'i bashkohet Ferrarit në vitin e ardhshëm. Fillimisht ishte Toto Wolff që foli për holandezin dhe nuk ia mbylli derën. Të mërkurën George Russell dhe Lewis Hamiltoni iu drejtuan medieve me temën e ardhjes së mundshme të kampionit të trefishtë në ekipin e tyre, diçka që vetë Max, në konferencën e fundit për shtyp të ditës, e hodhi poshtë plotësisht. "Mendoj se Verstappeni është në listën e ngushtë të Mercedesit", ka thënë ish-kampioni, i cili shtoi se nuk ka informacion për këtë temë, por gjithçka është e mundur. "Lëvizja ime ka treguar se gjithçka është e mundur. Ne do të kemi gjashtë muaj shumë interesantë", ka shtuar ai.

Ai ende nuk e kupton pse kampioni në fuqi "do të braktiste një makinë kaq të mirë". Lewisi dha pikëpamjen e tij për marrëdhënien



midis Max Verstappenit dhe babait të tij: "Unë mendoj se është si të ecësh në një vijë të mirë, por kjo varet nga marrëdhënja që ke me prindërit". Ai nuk donte të fliste shumë për këtë, pasi nuk di për marrëdhënien e tyre, por beson se Maxi nuk ka nevojë për këshilla nga babai i tij, apo dikush tjetër. "Max është një burrë i rritur dhe një kampion. Jam i sigurt se ai mund t'i marrë vendimet e tij, ndonjëherë është e lehtë që njerëzit e tjerë të mos ju drejtojnë

gjithmonë në drejtimin e duhur". Siç shpjegoi ai në Bahrein, i vjen keq për trajtimin e çështjes Horner nga Red Bull. "Si një person që e do sportin, është vërtet zhgënjyese të shohësh se çfarë po ndodh në këtë moment", ka shtuar ai. "Nuk duket mirë nga jashtë dhe nuk duket mirë as nga brenda, mund t'ju them këtë, dhe transparenca është një gjë e rëndësishme", ka deklaruar Hamiltoni, duke thënë se është një vendim shumë i rëndësishëm për F1.

## Denveri mposht Bostonin, fituan edhe Dallasi dhe Minnesota

**DENVER, 8 MARS** - Denveri fitoi me rezultat 115-109 ndaj Bostonit në përballjen mes dy ekipeve pretendente për titull në NBA. Kjo është humbja e dytë radhazi për Celticsin. Ndeshje me rivalitet, ku për Denverin u dallua Nikola Jokiq, autor i një "triple double" (32 pikë, 12 rebounde, 11 asistime). Për Bostonin, Porzingis realizoi 24 pikë e 12 rebounde, por që s'mjaftuan për fitore. Zhgënjeu ekipi i Golden States, që në fushën e tij u mund



nga Chicago (125-122). Vuçeviq dhe DeRozan realizuan nga 33 pikë secili për Bulls-in, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Thompsonit për Warriorsin. Minnesota mbron vendin e parë në Perëndim pas

fitores me rezultat 113-111 ndaj Indianas, sfidë ku dallimin e bëri Edwardsi, me 44 pikë. Dallasi, falë 35 pikëve, 11 reboundeve e 11 asistimeve të Luka Doniqiqit, mundi me rezultat 114-108 Miamin.

### REZULTATET

Detroit - Brooklyn	118-112
Indiana - Minnesota	111-113
Dallas - Miami	114-108
Phoenix - Toronto	120-113
Denver - Boston	115-109
Golden State - Chicago	122-125
Sacramento - San Antonio	131-129

## PSG-ja, gati 140 milionë euro për Sakan

PSG-ja është i gatshëm të paguajë 140 milionë euro për të nënshkruar me yllin e Arsenalit, Bukayo Saka, i cili shihet si zëvendësues i Kylian Mbappes. Gjigantët francezë tashmë po përgatiten për jetën pa Mbappen, i cili do të largohet nga klubi në fund të

kontratës së tij këtë verë. Mbappe ka qenë shumë i lidhur me një kalim te Real Madridi me kosto zero, megjithëse nuk ka pasur asnjë konfirmim nga asnjëra palë se një marrëveshje është arritur. PSG-ja është ende në kërkim të talentëve evropianë dhe ka vendosur

për yllin e Arsenalit, Saka, si objektivi i tyre kryesor për ta zëvendësuar Mbappen. Sipas spanjollës "Fichajes", e cila pretendon se Saka është në krye të listës së tyre për verë. Shtohet se PSG-ja është e gatshme të bëjë një ofertë prej të paktën 140 milionë eurosh për Arsenalin.

### SHKURT

#### Gjimshiti: Ndaj Sportingut na mungoi fati

Mbrojtësi i Atalantës, Berat Gjimeshi, u shpreh i lumtur pas barazimit 1-1 me Sportingun në Ligën e Evropës. Mbrojtësi kuqez i mendon se skuadrës italiane i mungoi edhe fati në këtë ndeshje. "Gjëja më e rëndësishme ishte të vinim këtu dhe të bënim lojën tonë si gjithmonë. Skuadra bëri një reagim të mirë. Nuk ishte e lehtë të vinim në Portugali dhe të krijonim më shumë se Sportingu pas 2-3 ndeshjeve të fundit që kemi zhvilluar. Na mungoi fati, por rezultati 1-1 është pozitiv. Kualifikimin do ta luajmë në fushën tonë. E pashë mirë skuadrën, nuk kishim presion. Vinim nga ndeshje të vështirë në të cilat kemi dhënë gjithçka, por edhe kemi gabuar. Është një periudhë ku po luajmë çdo 3-4 ditë. Tashmë jemi mësuar të zhvillojmë 4 ndeshje në 11 ditë. Është momenti të fokusohemi te dueli me Juventusin", ka shtuar Gjimeshi.

#### Lukaku: Tifozët më duan në Romë

Sulmuesi belg Romelu Lukaku po kalon një sezon të mirë te skuadra e Romës, tek e cila është në huazim nga Chelsea. Lukaku e ndihmoi Romën që ta mposhtë Brightonin (4-0) në Ligën e Evropës, duke shënuar golin e dytë të ndeshjes. "Këtu te Roma është ndryshe, këtu tifozët më duan mua. Po e bëj më të mirën pasi që klubi më ka ndihmuar. E ardhmja dhe huazimi që përfundon nga Chelsea në fund të qershorit? Unë duhet të kem kujdes me këto përgjigje", ka thënë Lukaku.

#### Dortmundi planifikon marrëveshje me Nagelsmannin pas Evropianit

E ardhmja e trajnerit Edin Terziq te skuadra e Borussia Dortmundit është në dilemë. Ai mund t'i lërë verdhezinjtë në fund të sezonit, duke qenë se skuadra e tij nuk po shkëlqen ashtu sikurse pritej. Sipas asaj që shkruan "Footmercato.net", një nga profilet që do të lidhë me ngulm me Borussia sezonin e ardhshëm do të ishte ai i Julian Nagelsmann. Ai është trajneri aktual i Gjermanisë, të cilit kontrata me Federatën i skadon në fund të Kampionatit Evropian. Nagelsmann, që më herët ka drejtuar edhe Bayern Munchenit, nuk do të ishte kundër rikthimit në një klub. Por, fillimisht, ai dëshiron ta vlerësojë projektin e hedhur nga verdhezinjtë. Gjithashtu, një sukses i mundshëm, në Euro 2024 me kombëtaren mund t'i hapte dyert një rinovimi të mundshëm. Ndërkohë që, te Borussia Dortmundi presin një sinjal nga Nagelsmann, që e konsiderojnë ideal për ta drejtuar skuadrën.

#### Solskjaer: Unitedi gaboi me rikthimin e Ronaldos

Ish-trajneri i Manchester Unitedit nga viti 2018 deri në vitin 2021, Ole Gunnar Solskjaer, është rikthyer të flasë për transferimin e Cristiano Ronaldos nga Juventus. Sipas teknikut norvegjez, kjo ishte një lëvizje e gabuar e drejtuesve të klubit, pasi Ronaldo ndikoi në atmosferën e skuadrës. "Cristiano është një lojtar i ndryshëm nga Rashford, Martial, Cavani apo Greenwood. Ai që e vuajti më shumë transferimin e Ronaldos ishte Cavani. Duhej të luanim në një mënyrë tjetër dhe ia komunikua Cavanit se gjithçka kishte ndryshuar. Ronaldo nuk ishte një problem kur ne e kishim kontrollin e topit, por e dinim se nuk mund të mbështeteshim tek ai kur kundërshtari luante topin ndaj na u desh të ndryshonim disa aspekte. Para se të vinte Ronaldo ishim një nga skuadrat që bënim më shumë presion", ka thënë Solskjaer. "Mendoj se transferimi i Ronaldos ishte më shumë për çështje pasioni sesa logjike. Megjithatë, u mendua se një profesionist si Ronaldo do të ndikonte për mirë te Rashfordi, Greenwood apo Martial. Por, nuk shkoi kështu. Nuk ishte e lehtë ta menaxhoje. Kur mbërriti më tha që ta aktivizoja për tri ndeshje me radhë dhe në ndeshjen e katërt ta ulja në stol. Kur e ula në ndeshjen e katërt nisi të ankohej. E jeton futbollin në një mënyrë shumë pasionuese", ka shtuar Solskjaer.









# TRADITË QË NGA

# 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

